

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **616-26-2558-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me inventar në qendra të ndryshme sociale**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	HM Home SH.P.K.
NUI	812133304
Adresa	Rruga e Transitit Petrovë Prizren
Vendi	Prizren
Kodi postar	20000
Numri Telefonit	+383 49 741 566
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Erjon Morina
Adresa elektronike	hmhomeshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	19.05.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me inventar në qendra të ndryshme sociale

Autoriteti Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES ka publikuar njoftimin për kontratë për prokurimin me titull: **Furnizim me inventar në qendra të ndryshme sociale**. me datë: **28.04.2026 09:31**. Afati i kërkesës për sqarimin e tenderit është deri me datën **08.05.2026**. Afati i fundit për dorëzimin e tenderit është me **20.05.2026**, në ora **14:00:00** Kriteri për dhënie të kontratës është: Tendei i përgjegjshëm me çmimin më të ulët – ne kemi dorëzuar kërkesën tek Autoriteti Kontraktues me datë **13.05.2026** për heqjen e kriterve diskriminuese mirpo Autoriteti Kontraktues nuk na ka kthyer asnjë përgjigje duke i thyer të gjitha rregullat e prokurimit publik ne sod me datë **19.05.2026** po paraqesim Ankesë në OSHP.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës ka publikuar njoftimin për kontratë për projektin në fjalë me datën 28.04.2026. Pasi kemi shkarkuar dosjen e tenderit

kemi vërejtur që Autoriteti Kontraktues ka vendosur kritere diskriminuese të cilat na pamundësojnë pjesëmarrjen si dhe në bazë të kritereve të përcaktuar haptas po shihet që Autoriteti Kontraktues po e favorizon një grup të paracaktuar pasi që kriteret i janë përshtatur atij grupi. Duke parë se janë vendosur kritere diskriminuese me datën 13.05.2026 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim të kritereve në të cilën kemi kërkuar nga AK që: në përputhje me dispozitat e LPP-së të të mënjanon kriteret diskriminuese teknike të përzgjedhjes të cekura në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë si dhe të zgjatet afati për dorëzimin e ofertave me paralajmërimin që nëse nuk mirret parasysh kërkesa jonë do të paraqesim ankesë në OSHP dhe do të njoftojmë organet tjetër kompetente.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Duke u bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik në Kosovë me nr. 04/L-042 , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 mendojmë që Autoriteti kontraktues i ka shkelur dispozitat e LPP-së si në vijim:

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 te LPP-së

Neni 7 te LPP-së

Neni 28 te LPP-së

Neni 51 i LPP-së

Neni 52 i LPP-së

Neni 108 paragrafi 7 i LPP-së

Neni 4 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 6 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 7 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 9 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 21 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 22 i Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

Neni 40 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejtshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues komuna e Prishtinës ka publikuar njoftimin për kontratë me titull: Autoriteti kontraktues **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES** ka publikuar njoftimin për kontratë me titull: **Furnizim me inventar në qendra të ndryshme sociale**, me nr. të prokurimit: **616-26-2558-1-2-1**.

Pasi kemi shkarkuar njoftimin, kemi parë që Autoriteti Kontraktues ka paraqitur disa kërkesa të kualifikimit të cilat haptas favorizojnë ndonjë operator ekonomik të paracaktuar pasi që pas shqyrtimit të Dosjes së Tenderit dhe kërkesave të përcaktuara lidhur me kapacitetin ekonomik, teknik dhe profesional, konsiderojmë se një pjesë e madhe e kriterëve të vendosura janë jo proporcionale me natyrën e kontratës dhe në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurim Publik, duke kufizuar konkurrencën e lirë dhe trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomik.

Pra tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 që me rastin 2.OE ofertues duhet të caktoj një Menaxher të projektit i cili duhet të jetë dizajner i Enterierit Inxhinier i diplomuar. ose Master – 5 vite përvojë pune pas diplomimit. 2. OE me vendim duhet të emëroj menaxherin e projektit me së paku 5 vite përvojë pune e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin origjinale.

2.Pra Menaxheri të Projektit – Dizajner Enterieri/Inxhinier i diplomuar ose Master me 5 vite përvojë pune, në këtë kërkesë e kundërshtojmë pasi që objekti i kontratës ka të bëjë me furnizim me mobilie dhe jo me projektim profesional të enterierit apo shërbime arkitektonike kjo kërkesë është joproportionale me natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe kufizon konkurrencën duke favorizuar operatorë ekonomik të caktuar që posedojnë staf specifik profesional, i cili nuk është i domosdoshëm për realizimin e kontratës andaj

kerkojm qe kjo kerkese te hiqet.

Pra tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 qe me rastin 3. OE ofertues duhet të ketë një Inxhinier te diplomuar te Emergjencave ose master me se paku 5 vite pervoje pune pas diplomimit, i cili duhet te jetë i certifikuar si Ekspert për siguri ne punë dhe mbretje nga zjarri. 3. Të dëshmohet me kopje të diplomës, kontratë te punës me punëdhënësin ose marrveshje për këtë projekt dhe CV e nenshkruar, certifikaten per siguri dhe shendet ne pune dhe mbrojtje nga zjarri.

3.Pra e kundërshtojm edhe kete kërkes te Autoritetit Kontraktues për angazhimin e një Inxhinieri të Emergjencave të diplomuar ose master me së paku 5 vite përvojë pune, të certifikuar si ekspert për siguri dhe shëndet në punë dhe mbrojtje nga zjarri, pasi që kjo kërkesë nuk ka lidhje me natyrën e kontratës e cila ka të bëjë me furnizim me mobilie kjo kërkesë është joproporcionale, diskriminuese dhe e panevojshme për realizimin e kontratës, pasi furnizimi dhe montimi i mobilieve nuk përbën aktivitet të tillë teknik apo industrial që kërkon angazhimin e një eksperti të emergjencave apo specialisti për mbrojtje nga zjarri vendosja e kësaj kërkesë kufizon konkurrencën dhe bie ndesh me parimet e proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik për këto arsye, ky kriter është i pavlefshëm juridikisht, nuk prodhon efekt ligjor dhe duhet të hiqet menjëherë.

Pra tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 qe me rastin 4. OE Ofertuse duhet te ketë se paku pesëmbëdhjetë (15) punëtorë tjerë ndihmës të angazhuar për këtë projekt të trajnuar për mbrojtje dhe siguri në punë Certifikatat Valide dhe 5 të tjerë për mbrojtje nga zjarri, Certifikatat Valide. 4.Të prezantohen Certifikatat Valide te bashkangjitet lista e puntorve, te bashkangjitet licenca e kompanisë qe ka kryer trajnimin e punëtorve.

4.Pra e kundërshtojm në tërësi kete kërkes te Autoritetit Kontraktues që Operatori Ekonomik të posedojë së paku pesëmbëdhjetë (15) punëtorë të trajnuar për siguri dhe shëndet në punë si dhe pesë (5) punëtorë të trajnuar për mbrojtje nga zjarri, me certifikata valide, pasi që kjo kërkesë është skajshmërisht joproporcionale, diskriminuese dhe në kundërshtim me natyrën reale të aktivitetit të prokurimit objekti i kësaj kontrate ka të bëjë me furnizim me mobilie dhe nuk paraqet projekt ndërtimor, industrial apo aktivitet teknik të rrezikshmërisë së lartë që do të arsyetonte kërkesa kaq të rënda dhe të ekzagjeruara lidhur me numrin e stafit të trajnuar për emergjenca, siguri në punë apo mbrojtje nga zjarri Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë asnjë arsyetim objektiv dhe proporcional se përse për realizimin e një kontrate furnizimi me mobilie nevojiten: 15 punëtorë të certifikuar për siguri në punë, dhe 5 punëtorë shtesë të certifikuar për mbrojtje nga zjarri kjo kërkesë tejkalon dukshëm nevojën reale të kontratës dhe krijon barriera artificiale për pjesëmarrje,

duke kufizuar konkurrencën e lirë dhe duke favorizuar operatorë të caktuar ekonomik që paraprakisht posedojnë struktura të mëdha organizative, pa pasur kjo lidhje me cilësinë e furnizimit po ashtu, kërkesa për certifikime masive të stafit përbën barrë të panevojshme administrative dhe financiare për operatorët ekonomik, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, duke cenuar drejtpërdrejt parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik kërkesa e tillë nuk është në harmoni me objektin e kontratës dhe nuk ndikon në mënyrë reale në aftësinë e operatorit ekonomik për të furnizuar mobiliet e kërkuara dhe duhet të hiqet menjëherë.

Pra tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 që me rastin 5.OE duhet të ofroj deshmë nga prodhuesi (opo dileri) për ISO standarte si në vijim ISO 10002 2018 ISO TC 136 ISO 19682 2023 ISO 10204 EN 1335-1 EN 10901 2009 A1 2011 TS EN 10204 2007 TS ISO 21524 2021. 5.Dëshmia kopjat e ISO Certifikatave të kërkuara.

5. Pra e kundërshtojm në mënyrë të prerë kërkesën e Autoritetit Kontraktues për posedimin e një numri të madh standardesh ISO/EN/TS, përkatësisht:ISO 10002:2018, ISO TC 136, ISO 19682:2023, ISO 10204, EN 1335-1, EN 1090-1, TS EN 10204, TS ISO 21524:2021,pasi që këto standarde, në mënyrën si janë vendosur në Dosjen e Tenderit, janë të paarsyeshme, të shpërndara në mënyrë të pakonsoliduar dhe në pjesën më të madhe të tyre nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën e kontratës që ka të bëjë me furnizim të thjeshtë me mobilie këto standarde i përkasin fushave të ndryshme teknike dhe industriale si:menaxhim i proceseve të cilësisë,struktura metalike dhe inxhinierike,sisteme teknike të specializuara,dokumentim dhe procese laboratorike,dhe fusha që tejkalojnë dukshëm furnizimin standard me mobilie vendosja e tyre si kërkesë obligative për pjesëmarrje në tender krijon një pengesë të pajustificuar dhe artificiale për operatorët ekonomik, duke kufizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë konkurrencën e lirë dhe duke eliminuar nga pjesëmarrja një numër të madh operatorësh të kualifikuar që realisht janë të aftë të realizojnë kontratën Autoriteti Kontraktues nuk ka arritur të dëshmojë lidhjen funksionale dhe proporcionale ndërmjet këtyre certifikimeve dhe objektit të kontratës, gjë që përbën shkelje të parimeve themelore të prokurimit publik, veçanërisht parimit të proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit në këtë kontekst, kërkesa për të gjitha këto standarde paraqet: tejkallim të nevojës reale të kontratës, specifikim të panevojshëm teknik, dhe barrierë të drejtpërdrejtë për konkurrencë efektive në treg për këto arsye, kërkojmë që kjo kërkesë të hiqet në tërësi nga Dosja e Tenderit, si kërkesë e panevojshme, joproporcionale dhe kufizuese, e cila bie ndesh me qëllimin e vetë Ligjit për Prokurimin Publik dhe me parimet bazë të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik.

Pra tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 që me rastin 6. OE ofertues duhet të posedoj 1. Kamion transportues, 2. Furgon transportues, 2. Pikup. 6. Lista e Pajisjeve, mjeteve, makinave teknike, mbi pronësinë (apo të marrjes me

qira) të mjeteve, stabilimenteve, pajisjeve teknike dhe kapacitetet tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje te Tenderit). Lista paisjeve dhe mjeteve, makinave teknike te OE duhet te jetë origjinale , e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik, duhet të ofroj si dëshmi, Fotografji , Specifikacion teknik, Libreza, për paisjet qe nuk regjistrohen te deshmoen me dud doganor te noterizuar ose Faturë.

6. Pra e kundërshtojm në mënyrë të prerë kërkesen e Autoritetit Kontraktues për posedimin e detyrueshëm të automjeteve specifike të transportit, përkatësisht kamion, furgon dhe pickup, si kusht kualifikues për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit kjo kërkesë është e paarsyeshme, joproporcionale dhe nuk është në përputhje me natyrën reale të kontratës, e cila ka të bëjë me furnizim me mobilie dhe jo me shërbim transporti si aktivitet kryesor ekonomik. vendosja e detyrimit për posedim të drejtpërdrejtë të flotës së plotë të automjeteve paraqet kufizim artificial të konkurrencës dhe eliminon nga pjesëmarrja operatorët ekonomikë që janë plotësisht të aftë për realizimin e kontratës përmes zgjidhjeve normale të tregut, si nënkontraktimi apo marrëveshjet logjistike Autoriteti Kontraktues nuk ka ofruar asnjë arsytim objektiv dhe të bazuar në nevojë reale se përse për furnizimin dhe transportin e mobilieve kërkohet posedimi i domosdoshëm i:

- kamionit transportues,
- furgonit transportues,
- dhe pickup-it,

kur këto shërbime në praktikë mund të realizohen në mënyrë më fleksibile, më efikase dhe më ekonomike edhe pa posedim direkt të mjeteve nga vetë operatori ekonomik kjo kërkesë krijon barriera të panevojshme hyrjeje në treg, duke favorizuar vetëm kompani të mëdha që kanë asetet e tilla në pronësi, dhe duke diskriminuar operatorët ekonomikë të mesëm dhe të vegjël, të cilët mund ta realizojnë kontratën në mënyrë të plotë dhe profesionale përmes organizimit normal të zinxhirit të furnizimit për më tepër, një kërkesë e tillë bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe me parimin e konkurrencës së lirë, pasi e shndërron një kontratë furnizimi në një garë posedimi asetesh, gjë që nuk është qëllim i Ligjit për Prokurimin Publik në këtë kontekst, kërkohet që kjo kërkesë të hiqet në tërësi nga Dosja e Tenderit, pasi është kufizuese, diskriminuese dhe nuk ka asnjë lidhje të domosdoshme me aftësinë reale të operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në mënyrë të suksesshme.

Pra tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 qe me rastin 8. OE ofertues duhet te sjelle Planin Dinamik, te detajuar per secilin pozicion. 8. Plani dinamik i detajuar i vulosur dhe i nënshkruar.

8. Pra e kundërshtojm në mënyrë të prerë kërkesen e Autoritetit Kontraktues për dorëzimin e një “plani dinamik të detajuar për secilin pozicion”, pasi kjo kërkesë është e ekzagjeruar, joproportionale dhe nuk ka asnjë lidhje reale me natyrën e kontratës që është furnizim me mobilie një plan dinamik i detajuar për çdo pozicion është instrument tipik i përdorur në kontrata të punimeve ndërtimore, inxhinierike apo projekte komplekse infrastrukturore, ku ka faza të shumta ekzekutimi, varësi teknike ndërmjet aktiviteteve dhe afate të ndërthurura zbatimi. Në rastin konkret, kontrata është furnizim standard me mobilie, ku aktivitetet kryesore janë prodhimi, transporti dhe dorëzimi, pa procese të ndërlikuara të menaxhimit të fazave të punës vendosja e kësaj kërkesë në këtë formë përbën:

- formalizëm të tepruar administrativ,
- barrë të panevojshme për operatorët ekonomikë,
- dhe kusht artificial që nuk ndikon në cilësinë apo aftësinë reale të realizimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar në asnjë mënyrë se si një plan kaq i detajuar për çdo pozicion ndikon në përmirësimin e ekzekutimit të një kontrate furnizimi, duke e bërë këtë kërkesë të dukshme si jo proporcionale dhe jo funksionale për më tepër, një kërkesë e tillë nuk i shërben as transparencës dhe as menaxhimit të kontratës, por vetëm rrit kompleksitetin e panevojshëm të ofertimit dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që realisht kanë kapacitet për furnizimin e kërkuar në këtë drejtim, kërkohet që kjo kërkesë të hiqet në tërësi nga Dosja e Tenderit, pasi është e panevojshme, e tepruar dhe në kundërshtim me parimet e proporcionalitetit, efikasitetit dhe konkurrencës së lirë në prokurimin publik.

Pra kontrata në fjalë ka të bëjë me furnizim me mobilie/interier dhe jo me punime teknike të natyrës së “Teknikës së Bardhë”, sistemeve TV, instalimeve teknike apo projekteve të inxhinierisë së avancuar. Për këtë arsye, një numër i konsiderueshëm i kriterëve të vendosura në Dosjen e Tenderit nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës dhe tejkalojnë dukshëm nevojën reale të Autoritetit Kontraktues (AK). Këto kërkesa, të cilat duken të hartuara për një profil specifik të operatorit, krijojnë bariera artificiale në hyrjen në treg dhe cenojnë rëndë parimin e barazisë.

Duke marrë parasysh natyrën e furnizimit, kjo kontratë do të duhej të realizohej përmes

mini-konkurrencës në kuadër të marrëveshjeve ekzistuese të AQP-së. Ky veprim jo vetëm që do të kursente mjetet e buxhetit publik, por do të siguronte një proces transparent dhe eficient. Përkundrazi, vendosja e kriterëve specifike dhe të panevojshme teknike vetëm sa kufizon pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomikë (OE) të kualifikuar, duke e kthyer procedurën në një proces selektiv dhe jo-konkurrues mbështetur në argumentet e mësipërme, kërkojmë zyrtarisht largimin e menjëhershëm të kriterëve diskriminuese dhe joproportionale: Çdo kërkesë që nuk shton vlerë në cilësinë e furnizimit, por shërben vetëm si mjet eliminues, duhet të hiqet harmonizimin e kërkesave me natyrën reale të kontratës: Specifikimet teknike duhet të pasqyrojnë nevojën e AK-së pa e ngarkuar procesin me certifikime apo kapacitete që nuk janë relevante për ekzekutimin e kontratës në fjalë respektimin e parimeve themelore të LPP-së: Veçanërisht Nenin 7 (Barazia në Trajtim/Mosdiskriminimi) dhe Nenin 6 (Ekonomia, Eficienca dhe Efektshmëria), të cilët janë shtyllat e një prokurimi të shëndoshë rishikimin e plotë të procedurës: Kërkojmë që AK të rishikojë strategjinë e prokurimit në përputhje me praktikën e AQP-së, duke hapur rrugën për një konkurrencë të lirë, të drejtë dhe pa privilegje të paracaktuara autoriteti Kontraktues ka detyrim ligjor të sigurojë që procedura të zhvillohet në mënyrë të paanshme, transparente dhe konkurruese. Mosveprimi në këtë drejtim do të rëndonte më tej dyshimet për kurdisje dhe do të cenonte ligjshmërinë e të gjithë procesit të prokurimit.

Ne kemi dorezuar kërkesën tek Autoriteti Kontraktues me datë 13.05.2026 për heqjen e kriterëve diskriminuese mirpo Autoriteti Kontraktues nuk na ka kthyer asnjë përgjigje duke i thyer të gjitha rregullat e prokurimit publik në shtet me datë 19.05.2026 po paraqesim Ankesë në OSHP pasi që me rastin e mos nxerrjes së vendimit apo mos kthimit të një përgjigje kemi vënë re se ka shkelje flagrante të ligjit pra kërkojmë nga ju që Autoritetin Kontraktues ta ndershkoni pasi që Duke pasur parasysh se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit (ZPP) ka treguar papërgjegjësi totale profesionale, duke shkelur me vetëdije Nenin 108A të LPP-së dhe duke mos kthyer përgjigje, kërkojmë që OSHP, në bazë të kompetencave të saj sipas **Nenit 131 të LPP-së**:

- T'i shqiptojë **gjobën maksimale financiare** të lejuar me ligj Autoritetit Kontraktues dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit (ZPP) për shkelje flagrante të afateve dhe aplikim të heshtjes administrative.
- T'i dërgojë kërkesë zyrtare Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik (KRPP) për **revokimin (marrjen) e menjëhershme të Certifikatës Profesionale të Prokurimit** për Zyrtarin Përgjegjës të këtij aktiviteti, për shkak të shkeljes së rëndë dhe të qëllimtë të parimeve të transparencës dhe trajtimit të barabartë.
- Të njoftohet Menaxhmenti i lartë i Autoritetit Kontraktues për fillimin e procedurave disiplinore ndaj personave që me mosveprimet e tyre po shkaktojnë dëme në buxhetin e komunës dhe po bllokojnë prokurimin publik.

Andaj, Kërkojmë që në përputhje me dispozitat e LPP-së të lartcekura të heqni kriteret diskriminuese teknike të përzgjedhjes të cekura më lartë të cilat janë përfshirë në njoftim

për kontratë dhe në dosjen e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit në fjalë si dhe të zgjatni afatin për dorëzimin e ofertave përndryshe jemi të detyruar që të paraqesim ankesë në OSHP dhe do ti njoftojmë organet tjejar kompetente

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Duke pasur parasysh shkeljet të cilat i ka bërë Autoriteti Kontraktues më lartë neve nuk do të na shkaktohen dëme të drejtëpërdrejta materiale por se do të vinte në shprehje fitimi i humbur në rastë se ne nuk do të merrnim pjesë në këtë tender si pasoj e kriterëve diskriminuese të vëna nga Autoriteti Kontraktues.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*